



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200953/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 313, "Jordan Misja", Tiranë.*

Drejtuar: **Z. Admir ABRIJA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Arben TOTI
Drejtor i IEVP-së 313 "Jordan Misja", Tiranë

TIRANË

I nderuar z. Abrija,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në neni 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 313 "Jordan Misja" në Tiranë.

Inspektimi u krye në dt.29.06.2022 sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ligjore dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve. Një aspekt tjetër i vizitës ishte dhe kqyrja e kushteve infrastrukturore të institucionit për jetesë normale të të burgosurve, si dhe llojshmëria e aktiviteteve që zhvillohen jashtë dhomave të banimit, në klasa dhe në vendet e ajrimit, në funksion të rehabilitimit të tyre.

Grupi i inspektimit gjithashtu, kërkoi edhe një informacion në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, ka të drejtë dhe detyrimin kushtetues e ligjor, t'ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të parashtrori rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Vizita inspektuese në I EVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë, u zhvillua në kuadër të inspektimeve për vitin 2022 që MKPT kryen në institucionet e privimit të lirisë së personit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për personat që gjykatat kompetente kanë vendosur masën e sigurisë personale “arrest me burg”.

Grupi i inspektimit, bazuar në metodologjinë e inspektimit, u takua me drejtorin e I EVP-së 313, z.Arben Toti, si dhe shefin e policisë së institucionit, të cilët pasi u prezantuan, u vunë në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Në takim me drejtuesit e institucionit, grupi i MKPT-së kërkoi fillimisht një informacion të përgjithshëm në lidhje me respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurve në këtë institucion, ofrimin e shërbimeve ndaj tyre, plotësimin e kushteve infrastrukturore, si dhe llojet e aktiviteteve që zhvillohen me të paraburgosurit, për një jetesë normale të tyre.

Referuar informacionit, I EVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 *“Për disa ndryshime në Urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”*, **klasifikohet si institucion paraburgimi**, me një seksion paraburgimi, një seksion të veçantë për personat që konsiderohen “bashkëpuntorë të drejtësisë”, sipas kriterëve të ligjit nr.10461, datë 12.09.2011 *“Për mbrojtjen e dëshmitarëve të drejtësisë”*, i ndryshuar dhe një seksion (godina C), për zbatimin e regjimit të posaçëm (*i ashtuquajtur i 41-bis*), sipas kriterëve të nenit 17 të ligjit 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Në I EVP “Jordan Misja”, Tiranë, **ka një kapacitet fizik (nuk disponohet një urdhër i veçantë i DPB-së) për akomodimin e 500 personave**, nisur nga numri i dhomave të banimit dhe numri i shtretërve për fjetje për të paraburgosurit, ambientet e tranzitit, si dhe ambientet në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë (41 bis). Në regjimin e brendshëm, këto ambiente janë të ndara në 3(tre) godina (“A”, “B” dhe “C”).

Në ditën e inspektimit, në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, **ndodheshin 440 persona të paraburgosur**. Ndërsa, situata e popullimit për periudhën e fundit 6 – mujore, ishte si më poshtë vijon:

- Janar 2021 453 të paraburgosur/6 të dënuar
- Shkurt 2021 452 të paraburgosur/6 të dënuar
- Mars 2021 458 të paraburgosur/6 të dënuar

¹ Shkresë nr.K4/I15-2 prot., datë 1.10.2021 drejtuar DPB dhe drejtorit të I EVP 313.

- Prill 2021 460 të paraburgosur/6 të dënuar
- Maj 2021 451 të paraburgosur/5 të dënuar

Referuar statistikave të popullimit, konstatohet se, në IEVP 313 nuk ka patur situata mbipopullimi. Prezenca e një numri të vogël të dënuarish, të pajisur me vendime të formës së prerë të gjykatave kompetente, kishte të bënte me dinamikën e shqyrtimit të çështjeve dhe vendimeve të gjykatave kompetente, si dhe me kohën e nevojshme në dispozicion të DPB-së, për transferimin e tyre në IEVP-të e tjera, referuar historikut të veprës penale të kryer prej tyre dhe problematikave që ata mbartin.

Ambientet e shërbimeve si ato të shërbimit shëndetësor, kuzhina dhe lavanderia, dhomat e takimit me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes, postet e takimit me familjarët, si dhe sektori i tranzitit, observimit dhe veçimit, ndodhen në katin e parë të godinës “A” dhe godinës “B” në regjimin e brendshëm. Gjithashtu, në godinën “A” dhe godinën “B”, ndodhej edhe nga një Seksion i Kujdesit të Veçantë (SKV), ku trajtohen kryesisht persona të sëmurë me probleme të shëndetit mendor.

Struktura organike e IEVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë, është e miratuar me urdhër nr.43, datë 25.03.2021 të Kryeministrit të RSH “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj”. Organika përbëhej nga 323 punonjës, prej të cilëve 36 punonjës të sektorit civil (4 punonjës të sektorit të çështjeve shoqërore ishin të komanduar nga IEVP Vaqarr) dhe 287 punonjës të sektorit të policisë.

Mungesat në organikë konsistonin përkatësisht: 1 pozicion drejtori i IEVP-së (i komanduar), 1 përgjegjës i sektorit të burimeve njerëzore, 1 sanitare dhe 8 punonjës policie të rolit bazë. Pavarësisht mungesave në organikë, grupi i inspektimiti konstatoi se, ato nuk ndikonin në ofrimin e shërbimeve bazë ndaj të burgosurve.

Nga informacioni i referuar, si dhe inspektimi i kryer në ambientet e regjimit të brendshëm, situata e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, rezultoi si më poshtë vijon:

1. Në ambientet e brendshme të godinës “A”, ishin kryer disa rikonstruksione të pjesshme për mirëmbajtjen e dhomave të banimit, por ato nuk kishin ndikuar në përmirësimin e cilësisë të jetesës të të paraburgosurve, pasi dhomat e banimit janë me përmasa të vogla dhe vijnë të kishte prezencë lagështie.
2. Kuzhina e institucionit kishte përmirësuar cilësinë e gatimit të ushqimit dhe ishte kompletuar me karroca për shpërndarjen e ushqimit sipas sektorëve.
3. Sektori i çështjeve shoqërore, kishte plane dhe programe të veçanta trajtimi individual dhe me grupe, sipas grup moshave dhe interesave të të paraburgosurve, me qëllim rehabilitimin, këshillimin dhe ri-integrimin e tyre.
4. Ishin marrë masa për vënien në funksion të ambientit të palestrave dhe plotësimin e tyre me vegla force të nevojshme.
5. Në ambientin e takimeve ishte shtuar edhe një kompjuter për plotësimin e kërkesave të të paraburgosurve për komunikimin online me familjarët e tyre.

6. Njësia tregtare në institucion ishte funksionale, për t'ju dhënë mundësinë të paraburgosurve të blinin produkte të ndryshme, sipas nevojave të tyre.
7. Organika e institucionit ishte plotësuar me 1 përgjegjës i sektorit të logjistikës, 1 specialist në sektorin e shërbimit ligjor, 1 farmacist dhe 1 infermier.
8. Institucioni kishte bërë funksionale lavanderinë, për larjen e materialeve të fjetjes për të paraburgosurit dhe teshave personale.
9. Në kuadër të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për trajtimin dinjitoz të të burgosurve që vendosen në seksionin e posaçëm të regjimit të sigurisë së lartë në IEVP (*i ashtuquajtimi 41-biss*), kishin filluar të zbatoheshin disa masa të pjesëshme si, përmirësimi i menisë dhe cilësisë së ushqimit, si dhe kishin vendosur guzhiner të veçantë për gatimin e ushqimit për këta persona. Gjithashtu, po merreshin masa nga DPB-ja që në çdo dhomë të montoheshin TV, me programe të kontrolluara dhe orar të reduktuar.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet që ende nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar, janë konkretisht:

1. Nuk ishin lidhur ende **kontratat e punësimit** midis të paraburgosurve të punësuar dhe institucionit, në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.10.2021, për shpërblimin financiar për punën e kryer.
2. Nuk ishte miratuar **Rregullorja e brendshme e institucionit**, menjëherë pas miratimit të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
3. Kushtet materiale të qëndrimit dhe të fjetjes së të burgosurve që akomodohen në **sektorin e tranzitit dhe të observimit**, nuk ishin përmirësuar, por ishin përkeqësuar. Kjo situatë, ishte me pasoja për shëndetin e personave që ndodheshin në këto ambiente.
4. Numrat e telefonave për të komunikuar me institucionin e Avokatit të Popullit, **nuk ishin të afishuara në vende të aksesueshme** dhe të paraburgosurit **nuk** mund të lidheshin në çdo kohë dhe pa pagesë², në lidhje me adresimin e ankesave për shkeljen e të drejtave të tyre ligjore nga administrata e IEVP-së.
5. Nuk ishin kryer **investime për riparimin e rrjetit të brendshëm elektrik** dhe sigurimin e kushteve të përshtatëshme për ngrohje të dhomave të të paraburgosurve në godinën “A” të këtij institucioni.
6. Të paraburgosurit **nuk furnizoheshin rregullisht me detergjentë**, për mbajtjen e higjienës dhe pastërtisë vetjake, si dhe mjediseve të banimit e ambienteve të përbashkëta.
7. Nuk janë ndërmarrë hapa konkretë, për ndryshimin e urdhërit të përbashkët nr.104/5 prot., datë 19.06.2006 të Ministrit të Drejtësisë dhe nr.205/5 prot., datë 27.07.2006 të Ministrit të Shëndetësisë, *“Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”*, me qëllim **përmirësimin e larmisë së menisë së ushqimit**³ për të burgosurit.

Vizita inspektuese në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi dhe grupit të MKPT-së ju ofruan të gjitha lehtësirat për kryerjen e inspektimit, kqyrjen e ambienteve në regjimin e brendshëm, si dhe zhvillimin e intervistave me të paraburgosurit pa mbikqyrjen e stafit të sigurisë së institucionit, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

² Neni 17 i ligjit 81/2020 dhe neni 67 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

³ Ky rekomandim i përket DPB-së si organ propozues, si dhe Ministrive respektive MD dhe MSHMS.

Trajtimi

Vizita e MKPT-së në IEVP 313 “Jordan Misja, kishte në fokus kryesor mbledhjen e informacionit nga inspektimi dhe intervistat me punonjësit e institucionit dhe me të paraburgosurit, me qëllim identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimin degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike përtej kufijve të parashikuar në aktet normative apo dhe të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie.

Në lidhje me këtë çështje të rëndësishme, grupi i inspektimit u njoh me dokumentacionin dhe administroi kopje të praktikave të punës të komisioneve të ngritura në këtë institucion, që kishin të bënin me trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të paraburgosurve, plotësimin e kushteve të sigurisë fizike dhe për jetesë të tyre, si dhe procedurat e ndjekura nga komisioni i disiplinës në rastin e marrjes së vendimit për dhënien e masave disiplinore të lehta apo të rënda për të paraburgosurit, në varësi të shkeljes disiplinore të kryer prej tyre, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

Nga informacioni i grumbulluar dhe nga intervistat individuale e me grupe të paraburgosurish, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për ushtrim të dhunës dhe keqtrajtim të tyre, si dhe tejkallim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve.

Pavarësisht situatës të përgjithshme në institucion, në intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit, u parashtruan disa ankesa që kishin të bënin me mungesën e kushteve të përshtatshme të jetesës në institucion, të cilat përbënin një trajtim jo dininjtoz për këta persona. Ankesa më së shumti u ngritën nga të paraburgosurit që ndodheshin në godinën “A”, e cila është një godinë e vjetër dhe e amortizuar.

Nisur nga objekti i ankesave dhe inspektimi që zhvilloi grupi i MKPT-së në këtë godinë, ato konsistonin në pakënaqësinë për:

- përmasat e vogla të dhomave të banimit, të cilat nuk plotësonin kriteret e sipërfaqes dhe të hapsirës së lejueshme, që duhet të sigurohet për çdo të burgosur;
- prezencën e lagështirës në disa nga dhomat e banimit dhe në nivele më të larta ajo ishte prezente në ambinetet e përbashkëta të tualeteve dhe të dusheve;
- problemet me sistemin e brendshëm elektrik që përbënte rrezik për sigurinë e jetës së të paraburgosurve, si dhe mungesën e një sistemi qëndror për ngrohje/ftohje të ambienteve të banimit;
- mungesën e ujit të ngrohtë për larjen e trupit, pasi bolierët nuk përballonin nevojat e të paraburgosurve;
- kushtet e papërshtatshme në ambientet e përbashkëta të klasave dhe në ambientet e ajrimit në godinën “A”, të cilat ishin shumë të kufizuara për zhvillimin e aktiviteteve, etj.

Një grup ankesash, kishin të bënin me mungesën e larmisë së ushqimit, pasi çdo ditë gatuhej e njëjta menu sipas vakteve të ushqimit. Nisur nga ky konstatim i përsëritur dhe nga ankesat e shumta të të burgosurve në IEVP-të e tjera, institucioni i Avokatit të Popullit, ka rekomanduar vitet e fundit ndryshimin e urdhërit të përbashkët nr.104/5 prot., datë

19.06.2006 të Ministrisë të Drejtësisë dhe nr.205/5 prot., datë 27.07.2006 të Ministrisë të Shëndetësisë, “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”, por konstatojmë se ky rekomandim ende nuk po zbatohet, pavarësisht se DPB-ja ka dy vjet që e informon institucionin e Avokatit të Popullit se, është ngritur një grup pune i përbashkët i dy ministrive dhe DPB-së, për këtë qëllim. Kjo problematikë bëhet edhe më serioze në kushtet e inflacionit të rritur këto kohët e fundit.

Një shqetësim i përsëritur që u ngrit nga të burgosurit të cilët ndodheshin në dhomat e observimit, veçimit dhe të tranzitit të këtij institucioni, kishte të bënte me kushtet e vështira të jetesës në këto ambiente, të cilat janë kushte degraduese dhe jo dinjitoze. Pavarësisht disa masave të pjesëshme, situata në këta sektorë nuk kishte ndryshuar nga inspektimi i vitit të kaluar. Veç kushteve të vështira, të burgosurit që akomodohen në dhomat e tranzitit, ankoheshin dhe për ditët e gjata të qëndrimit në këtë ambient, në varësi të planifikimeve të lëvizjeve që miratonte DPB-ja dhe datave të zhvillimit të seancave gjyqësore në gjykatat kompetente në Tiranë.

Situata e kushteve të jetesës në dhomat e banimit që ndodheshin në godinën “B” dhe godinën “C” (41 bish), kishin ndryshime të theksuara pozitive krahasuar me kushtet e jetesës në godinën “A”. Kushtet e akomodimit, pastërtia dhe higjienizimi i ambienteve, ishin në gjendje të mirë dhe plotësonin standardet e nevojshme për jetesë normale. Dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta, kishin hapsirat e sipërfaqet e lejuara, si dhe ishin të kompletuara me orenditë e nevojshme.

Masat mbrojtëse

Grupi i inspektimit të MKPT-së, u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit me praktikën e punës për secilin sektor, me qëllim vlerësimin e përgjithshëm të këtij institucioni, për respektimin dhe garantimin e të drejtave të të paraburgosurve.

U verifikua dokumentacioni dhe procedura që ndiqet nga punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore, në zbatim të kërkesave të ligjit 81/2020 dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, për funksionimin e sistemit të trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave në institucion.

Nga inspektimi u evidentua se, çdo kërkesë apo ankesë e të paraburgosurve plotësohej në një formular, i cili i dorëzohej punonjësit të edukimit sipas sektorit dhe brenda ditës kërkesë/ankesa protokollohej në sekretarinë e institucionit në një regjistër të veçantë të miratuar për këtë qëllim. Ky regjistër administrohej dhe plotësohej sipas rubrikave nga sekretaria e institucionit, si dhe ishte i vulosur me vulën e institucionit⁴.

Në varësi të natyrës të kërkesë/ankesës, drejtori i institucionit urdhëronte me shkrim sektorët përkatës t’i kthenin përgjigje ankuesit, e orientonin ankuesin ti drejtohej me shkresë zyrtare organit epror në DPB, si dhe organizonte takime me ankuesit në ambientet e regjimit të brendshëm, brenda një afatit 3(tre) ditor. Gjatë vitit 2022 ishin evidentuar në regjistër

⁴ Neni 58 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

gjithsej 774 kërkesë/ankesa nga të paraburgosurit, të cilat sipas shënimeve në regjistër ishin zgjidhur nga institucion ose ishin adresuar organit epror në DPB për ti zgjidhur ato.

Sipas shënimeve në regjistër, objektit i kërkesave kishte të bënte me kërkesa për takime me familjarë, kërkesë për takim me avokatë, komunikim me skype, vizita në spital, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer, etj.

Korrespondencat për kërkesë/ankesat me institucionet e tjera jashtë sistemit penitenciar, të paraburgosurit i depozitonin në një kuti postare që ndodhej në çdo sektorë në regjimin e brendshëm dhe më tej ato niseshin me postë sipas adresave. Nga inspektimi u evidentua se, **mungonte një regjistër** ku të regjistroheshin letrat që dërgonin të paraburgosurit, ndaj shpesh ata nuk ishin të informuar nëse ato ishte dërguar apo jo në destinacionin e kërkuar prej tyre.

Grupi i inspektimit, verifikoi dokumentacionin që mbahej në lidhje me procedurën e mbledhjeve të Komisionit të Pritjes në institucion për hyrjet e reja dhe pritjen e të paraburgosurve. Krahas mbledhjes së komisionit, anëtarët e komisionit sipas sektorëve evidentonin në formularë të dhënat kryesore të personit që nga pamja fizike e jashtme, gjendja shëndetësore, si dhe të dhëna për gjendjen psiko-sociale të personit. Gjithë praktika ishte e regjistruar në një regjistër të veçantë, i cili ishte i protokolluar dhe mbahej në sekretarinë e institucionit.

Masat disiplinore për të paraburgosurit, evidentoheshin në regjistrin e shkeljeve dhe masave disiplinore. Procedura e dhënies së masës disiplinore, ndiqej nga Komisioni i ngritur në këtë institucion për këtë qëllim dhe ishte e bazuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. I paraburgosuri që kishte kryer thyerjen e disiplinës, pasi njihej me vendimin e Komisionit, kishte të drejtën e ankimit pranë komisionit të apelit të masave disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit për dhënien e masës⁵.

Takimet me familjarët zhvilloheshin në ambientet e takimeve që ndodheshin në katin e parë të secilës godinë (A dhe B) në regjimin e brendshëm. Ndërsa, personat që ndodheshin në ambientin e regjimit të posaçëm (41 biss) kishin ambient me vehte takimi me familjarët. Numri i takimeve, sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, ishte 4 herë në muaj për të paraburgosurit në regjimin e zakonshëm dhe 1 herë në muaj për të paraburgosurit në regjimin e sigurisë së lartë. Organizimi i takimeve me familjarët respektohej nga drejtuesit e institucionit, ku sipas dëshirës së të burgosurve, njëri nga takimet mund të kryhej edhe online me skype. Nga intervistat, grupi i inspektimit nuk mori asnjë ankesë në lidhje me takimet apo për komunikimet në telefon me familjarët e tyre.

Komunikimi me telefon me familjarët, kryhej përmes aparateve të telefonave me kartë që ishin të instaluar në korridoret e secilit prej sektorëve në regjimin e brendshëm dhe në ambientet e ajrimit. Ata ishin në gjendje pune dhe të paraburgosurit e intervistuar deklarorin se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë. Shqetësimi që ngritën të

⁵ Neni 17 i ligjit 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" dhe neni 89 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

paraburgosurit kishte të bënte me çmimin e rritur të kartës telefonike, ndërkohë që koha e bisedës ishin zvogëluar.

Grupi i inspektimit, konstatoi gjithashtu se, numrat e telefonit të Avokatit të Popullit **nuk** ishin të afishuar në vende të aksesueshme për të paraburgosurit. Për shkak të kufizimit të numrit të telefonave (deri në 10 numra), ata deklarorin se, **nuk** mund të komunikorin me institucionin tonë me kohë bisede pa limit dhe pa pagesë. Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve thuhet shprehimisht se: *“I burgosuri mund të komunikojë me Avokatin e Popullit në telefon, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve në çdo kohë”*⁶. Sa më sipër, ky veprim është në shkelje të të drejtave të të paraburgosurve që çënon garancitë që atyre u jepen nga ligji.

Organika e I EVP “Jordan Misja”, Tiranë, kishte 25 të punësuar nga të paraburgosurit, të cilët punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Nga intervistat e zhvilluara, të burgosurit e punësuar deklarorin se nuk kishin pretendime për kushtet e punës, por sipas tyre ende nuk ishin lidhur kontratat e punës për shpërblimin financiar për punën e kryer, në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.01.2021. Kjo është shkelje e të drejtës ligjore të të burgosurve të punësuar (për të gjitha I EVP-të), për të përfituar pagesë mujore për punën e kryer, e drejtë kjo e njohur me ligjin 81/2020 (neni 44), por e mbetur pa realizuar në mënyrë efektive për shkak të nxjerrjes së akteve nënligjore prej mëse 2 viteve. Pasi kanë kaluar 8 muaj edhe nga miratimi i VKM-së nr.602, datë 13.01.2021, ende kjo e drejtë nuk është bërë efektive duke u shkelur të drejtën të paraburgosurve e të burgosurve.

Ambientet e I EVP “Jordan Misja”, Tiranë, ishin të monitoruara me sistemin e kamerave të sigurisë, që mbanin nën vëzhgim ambientet e jashtme dhe të brendshme të institucionit. Pamjet filmike të kamerave ruheshin në server për një periudhë deri në 30 ditë.

Grupi i inspektimit të MKPT-së, i kushtoi një vëmendje të veçantë kushteve për trajtimin e personave të paraburgosur që ndodheshin në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë të këtij institucioni, bazuar në kërkesat e nenit 17 të ligjit nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Regjimi i posaçëm ndodhej në godinën “C” të I EVP-së “Jordan Misja”, ku ishin akomoduar 5 persona të paraburgosur, sipas urdhërit të Ministrisë të Drejtësisë. Në katin zero ndodheshin ambientet e shërbimeve si mjedisi i takimit me familjarët (pesë poste takimi të ndara me xham dhe komunikimi kryhej përmes citofonisë), një dhomë e takimit me avokatin/prokurorin apo oficerin e policisë gjyqësore, një dhomë këshillimi, si dhe mjedisi i tualeteve dhe dusheve i ndarë në tre bokse.

Në katër katet e tjera (një kat i ndërtuar nëntokë), ndodheshin dhomat e të paraburgosurve dhe dushet e përbashkëta. Në ndryshim nga inspektimet e mëparshme, në katin që ndodhej nëntokë, nuk kishte asnjë të paraburgosur. Aktualisht ata ishin të akomoduar në katin e dytë dhe të tretë të kësaj godine. Në secilin kat ndodheshin 5(pesë) dhoma, të kompletuara me dy krevatë të fiksuar në dysHEME, një tavolinë e vogël, një kalorifer për ngrohje, një tualet

⁶ Neni 17 i ligjit 81/2020 dhe neni 67 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

me një lavaman me rubinet dhe një pasqyrë alumini e fiksuar në mur me vida. Dritarja ishte e mbyllur me dy kanate me xham dhe e siguruar në pjesën e jashtme me zgarë hekuri dhe me grrilë hekuri të fiksuar në mur.

Në takimin e zhvilluar nga grupi i MKPT-së me këta persona, u ngritën disa problematika që kishin të bënin me **mungesën e aktiviteteve** kulturore, sportive dhe fetare, si dhe mungesën e librave për lexim (në bibliotekë ka vetëm libra me karate fetar). Pavarësisht se ishin lejuar takimet fizike të të burgosurve të tjerë me familjarët, ende me këta të burgosur **nuk** kishin filluar takimet 1(një) herë në muaj, sipas rregullores. Gjithashtu, veç orarit të ajrimit ata kërkonin hapjen e palestrave për ushtrime force, si dhe mbajtjen e dyerve të hapura gjatë gjithë ditës, për arsye se dhomat e banimit **nuk** kanë ajrim dhe dritë natyrale të mjaftueshme.

Koha e ajrimit ishte i vetmi aktivitet që zhvillohej rregullisht me të paraburgosurit në këtë regjim. Ambienti i ajrimit ndodhej në sheshin përpara godinës “C” dhe përbëhej nga 4 bokse ajrimi të cilat ishin me gjatësi dhe gjerësi të mjaftueshme për të kryer lëvizje, ndërsa në pjesën e sipërme ai ishte i mbuluar me rrjetë, për arsye sigurie. Orari i ajrimit ishte përcaktuar në rregulloren e regjimit të posaçëm dhe kryhej rreth 2 orë në ditë.

Dushet e përbashkëta kishin nga 6 (gjashtë) bokse për larjen e trupit. Kokat e dusheve ndodheshin në lartësinë jo më shumë se dy metra nga dyshemeja, të fiksuara në murin ndarës të bokseve.

Në korridor ishin vendosur dy aparate telefona me kartë, për të komunikuar me familjarët e tyre, sipas procedurave të miratuara për këtë qëllim. Ndërsa, komunikimi me Institucionin e Avokatit të Popullit, nuk mund të kryhej. Sipas ligjit dhe rregullores kjo është e drejtë e çdo të burgosuri përfshirë edhe ata të gjendur në regjim të posaçëm. Gjithashtu numrat e telefonit nuk ishin të afishuar në korridoret e çdo sektori.

Qëllimi i regjimit të posaçëm është për të parandaluar kontaktet me organizatën kriminale ku i burgosuri bën pjesë, konfliktet me element të organizatave kundërshtarë, ndërveprimin me të burgosurit e tjerë që i përkasin të njëjtës organizatë ose organizatave të tjerë bashkëpunuese, komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të burgosurve që i përkasin grupeve të ndryshme etj.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit referuar standardeve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe dinjitetin njerëzor të këtyre personave, si dhe eksperiencat e vendeve të tjera ku është aplikuar ky regjim, ka rekomanduar lehtësimin e disa masave në këtë regjim, pasi këta këta të burgosur nuk duhet të privohen nga aktivitetet sportive, kulturore, krijuese, leximi i librave të shumëllojshëm, veprimtari që i shërbejnë rehabilitimit dhe ri-integrimit të tyre. Përkundrazi, aktivitetet me karakter edukues qofshin këto edhe individuale, në këtë regjim janë edhe më të domosdoshme se në çdo regjim tjetër, me qëllim për të zbutur rreptësinë e kufizimeve të parashikuara në ligj. Avokati i Popullit vëren se ndonëse raportohen edhe masa të përmirësuara (lëvizjes nga kati përdhe dhe vendimit për lejimin e kufizuar të pajisjeve TV edhe masat rezultonin shumë kufizuese).

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit dhe intervistat e zhvilluara me këta të paraburgosur, kishte filluar gatimi në kuzhinë i ushqimit me guzhiner më vehte, gjë e cila kishte sjellë përmirësimin cilësisë së ushqimit dhe larminë e menisë për secilin vakt ushqimor. Gjithashtu, ishte në fazë tenderimi nga DPB kompletimi i dhomave në këtë regjim me monitor TV me kanale dhe orare të reduktuar. Këto masa i vlerësojmë si hapa pozitiv drejt përmirësimit të trajtimit dhe krijimit të kushteve normale për këta persona, pavarësisht veprës penale që ata akuzohen se kanë kryer.

Kushtet materiale

Plotësimi i kushteve materiale për jetesë në IEVP, përbën një element shumë të rëndësishme në respektimin e të drejtave të të burgosurve, të garantuara me aktet ligjore dhe me aktet ndërkombëtare.

Në IEVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë, në regjimin e brendshëm ndodhen 3(tre) godina për banim dhe për shërbimet ndaj të paraburgosurve. Godina “A” është e ndërtuar prej vitesh dhe pavarësisht disa rikonstruksioneve të pjesëshme, godina është e vjetëruar dhe shumë e amortizuar. Ndërsa, godinat “B” dhe “C” janë ndërtuar vitet e fundit dhe kanë kushte dhe infrastrukturë më të mirë për jetesë. Në përgjithësi, infrastruktura e institucionit në regjimin e brendshëm plotëson nevojat e të paraburgosurve për jetesë normale dhe garantonte elementët e sigurisë.

Kubatura dhe sipërfaqet e dhomave të banimit ishin të vogla, në raport me numrin e personave të akomoduar në secilën prej tyre. Në dhoma ishin akomoduar nga 2-4 persona. Dhomat ishin të pajisura me orëditë e nevojshme si tavolinë, karrige dhe komodina, por ato nuk i plotësonin nevojat për mbajtjen e sendeve personale dhe ushqimeve të të paraburgosurve, duke i detyruar të burgosurit ti mbanin këto materiale në qeska të vendosura në dysheme. Niveli i ajrit dhe dritës natyrale në dhoma ishte në norma të lejueshme, ndërkohë që të gjitha ambientet në regjimin e brendshëm, kishin edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Situata e kushteve materiale paraqitej më e vështirë në godinën “A” të institucionit, për shkak të amortizimit në vite të godinës dhe ambienteve me kubatura dhe sipërfaqe të vogla që nga ndërtimi i saj. Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, kushtet materiale në këtë godinë nuk janë sipas parametrave teknik dhe jetësor të përcaktuar në legjisllacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vlen të theksojmë gjithashtu edhe rekomandimin e Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT), i cili shprehet se, norma minimum e hapësirës për person në institucione të tilla, është 6m² për dhomat për një person dhe 4m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2m distancë dhe jo më pak se 2.5m distancë (lartësia) nga dyshemeja me tavanin e dhomës.

Në vijim të këtij rekomandimi, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve parashikon se: *“Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë*

*konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.*⁷

Baza materiale hotelerie për jetesë ishte e plotësuar për çdo dhomë banimi. Të paraburgosurit ishin të kompletuar me krevat, dyshek, batanie, jastëk dhe çarçafë nga institucioni, por një pjesë e këtyre materialeve ishin të vjetëruara, sidomos dyshekët për fjetje. Sipas informacionit, sektori i logjistikës informoi grupin e MKPT-së se, zëvendësimi i materialeve të fjetjes të dëmtuara me të reja, bëhet sipas afateve të përdorimit të përcaktuara. Në këto kushte, të paraburgosurit deklarorin se, një pjesë të këtyre materialeve i siguronin nga familjarët e tyre.

Nisur nga infrastruktura e përgjithshme në regjimin e brendshëm të institucionit, kushtet materiale në të cilën ndodhen të paraburgosurit sidomos në godinën “A”, është e nevojshme të bëhet rishikimi i akteve të brendshme që përcaktojnë kapacitetin fizik të IEVP 313, me qëllim që personave që do akomodohen në dhomat e banimit, t’u garantohet e drejta për normat minimale të hapsirës dhe sipërfaqes për çdo të burgosur.

Ngrohja e ambienteve në regjimin e brendshëm kryhej me kaldajë qëndrore, por kishte problematikë pasi sistemi paraqiste defekte teknike dhe oraret për ngrohje të ambienteve gjatë ditës, ishin të kufizuara. Në këto kushte, nga ana e institucionit ishin marrë disa masa për të lejuar futjen e ngrohësave dhe ftohëseve elektrike në dhoma, sipas stinëve. Përdorimi i këtyre pajisjeve elektrike, krijonte për rrjedhojë ngarkesë në rrjet dhe defekte të shpeshta elektrike, kryesisht në godinën “A” ku sistemi elektrik ishte i amortizuar.

Ambientet e dusheve ishin të mirëmbajtura dhe në përgjithësi ishin me kushte të mira higjieno sanitare, sidomos në dy godinat e reja. Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit sipas sektorëve, nuk u paraqitën ankesa në lidhje me furnizimin me ujë apo larjen e trupit me ujë të ngrohtë 2 (dy) herë në javë.

Furnizimi me ujë të rrjedhëm i ambienteve në regjimin e brendshëm, kryhej rregullisht nga Ndërmarrja e UK Tiranë. Institucioni kishte vendosur edhe 4 (katër) depozita me ujë me kapacitet 5 000 litra secila, me një total prej 20 000 litrash. Ngrohja e ujit realizohej me bolier dhe me panele diellore. Në ambientet e përbashkëta, kishte bazë materiale të shpërndarë sipas nevojave.

Sektori i observimit, veçimit dhe ai i tranzitit ishin ambiente më vehte dhe ndodheshin në katin e parë të godinës “A” të këtij institucioni. Nga pikpamja e organizimit dhe procedurave që ndiqeshin, ato funksiononin normalisht sipas parashikimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Në ditën e inspektimit në sektorin e tranzitit ndodheshin 9 persona, në sektorin e observimit ndodheshin 2 persona (hyrje të reja), ndërsa në dhomat e veçimit nuk kishte asnjë person me masë disiplinore.

⁷ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, neni 30.

Grupi i MKPT-së, në mënyrë të përsëritur konstatoi se në këto ambiente kishte mungesë të theksuar të kushteve materiale për fjetje, lagështi të dhomave dhe mungesë të kushteve higjeno-sanitare.

Në dhomat e tranzitit akomodohen persona të ardhur nga IEVP-të e tjera në pritje të zhvillimit të seancave gjyqësore në gjykata kompetente dhe koha e qëndrimit të të burgosurve në këto dhoma ishte 4-7 ditë. Ndërsa, në dhomat e observimit dhe të veçimit të paraburgosurit qëndrojnë nga 1-15 ditë, sipas afateve të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për përshtatjen e hyrjeve të reja në institucion, si dhe vendimit të Komisionit të disiplinës për të paraburgosurit që kanë kryer shkelje të disiplinës.

Grupi i inspektimit të MKPT-së, në intervistat me këta të burgosur, mori ankesa për mungesën e bazës materiale për fjetje, duke i detyruar të flinin në dyshekë dhe batanie të vjetëruara që mbanin njëkohësisht edhe erë të rëndë myku. Ankesa u paraqitën edhe për nivelin e lartë të lagështirës në dhoma, për mungesë të rubinetave të çezmave dhe nyjeve hidrosanitare në tualete, papastërti dhe dhoma të palyera, si dhe për mungesë të enëve (pjata dhe gota) për konsumin vakteve ushqimore.

Gjendja e përsëritur në të cilën u konstatuan edhe këtë vit kushtet në sektorin e observimit, veçimit dhe të tranzitit, në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, përbënin një trajtim jo dinjitoz të personave që ndodheshin në këto ambiente, me pasoja të rënda në shëndetin e tyre. Dhomat kanë nevojë të menjëhershme për mirëmbajtje, për rinovimin e materialeve të fjetjes, lysterjen e dhomave dhe dizifektimin 3D, pasi personat që ndodheshin në këtë ambient ankoheshin se kishte brejtës të ndryshëm.

Në IEVP “Jordan Misja” kishte palestër, klasa dhe dhoma këshillimi sipas sektorëve. Palestra ishte pajisur me mjete të vëna në dispozicion nga institucioni, si dhe vegla për ushtrimin e forcës të sjella nga vetë të paraburgosurit. Ushtrimi në palestër dhe orari i ajrimit, ishin aktivitetet kryesore që zhvillonin të paraburgosurit.

Ambientet e kultit ishin të bollshme, me ndriçim dhe të pajisur me orënditë e nevojshme. Kryerja e riteve fetare, kishte filluar të lejohej, pas një kufizimi të gjatë të tyre, për shkak të periudhës së pandemisë.

Institucioni kishte në total 12 (dymbëdhjetë) ambiente ajrimi, nga të cilat 4 (katër) bokse ndodheshin në katin e tretë të godinës ‘A’ dhe 8 (tetë) bokse ndodheshin në sheshin mes godinave. Këto ambiente ishin të pastra dhe të mirëmbajtura. Në këto ambiente ndodheshin gjithashtu edhe telefona ku të paraburgosurit/dënuarit i shfrytëzonin për të kontaktuar me familjarët. Aparatet e telefonave ishin funksionale në të gjitha ambientet e ajrimit.

Kuzhina e institucionit ishte me hapsirë dhe sipërfaqe të mjaftueshme, si dhe me kushte higjeno-sanitare të mira. Ambienti i kuzhinës ishte i lyster. Brenda hapsirës të kuzhinës ndodhej edhe magazina për ushqimet. Kuzhina ishte në kushte normale, pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menuja ditore e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Stafi i kuzhinës përbëhej nga

6 guzhiner (2 të veçantë për regjimin e posaçëm) dhe 4 nd/guzhiner, pa llogaritur të punësuarit që shpërndanin ushqimin sipas sektorëve. Në momentin e inspektimit, po përgatitej shpërndarja e vaktit të drekës dhe u evidentua se, produktet ushqimore dhe të mishit, ishin sipas menuesë ditore. Të paraburgosurit e sëmurë me diabet dhe ata që ndodheshin në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë kishin menu gatimi më vehte.

Kampionët e ushqimeve ruheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Në përgjithësi, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit dhe të shpërndarjes sipas sektorëve, rezultuan në gjendje të mirë.

Krahas kësaj suate, disa nga të paraburgosurit ngritën ankesa për mungesën e larmisë së ushqimit dhe se merrnin ushqime nga familjarët e tyre. Ky shqetësim, është i përsëritur dhe i ngritur edhe në IEVP-të e tjera, mbi bazën e të cilave Avokati i Popullit ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë dhe Drejtorin të Përgjithshëm të Burgjeve, ndryshimin e kuotës ditore të ushqimit për të burgosurit, rekomandim që ende nuk është zbatuar.

Në IEVP “Jordan Misja”, kishte filluar të funksiononte njësi tregtare, ku tregtoheshin produkte të ndryshme ushqimore dhe për nevoja personale për të paraburgosurit. Nga drejtuesit e institucionit, u informuam se njësitë tregtare do të funksiononin mbi bazën e një projekti pilot që do organizohet nga Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve.

Gjithashtu, në IEVP 313 “Jordan Misja” kishte filluar të funksiononte lavanderia e kompletuar me lavatriçe për larjen e rrobave dhe lavatriçe për tharjen e tyre. Nga inspektimi rezultoi se, lavatriçet ishin në gjendje pune, por një pjesë e të paraburgosurve deklarorin se rrobat personale i dërgonin tek familjarët e tyre.

Regjimi dhe aktivitetet

Nga inspektimi i kryer në IEVP 313 “Jordan Misja”, rregjimi ishte i organizuar sipas orarit ditor të miratuar nga drejtori i institucionit. Orari i veprimtarive ishte i afishuar në vende të aksesueshme nga të paraburgosurit si zonën e kolonës të çdo sektori dhe në koridoret që dilnin në bokset e ajrimit. Veprimtaritë e parashikuara, ishin të njëjta sipas programeve të miratuara për çdo sektorë, pavarësisht nga siguria që ata kishin. Nga veprimtaritë ditore, bënin përjashtim të paraburgosurit që ndodheshin në regjimin e sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që kishin masa disiplinore.

Përsa i takon aktivitetet të zhvilluara, ato ishin të reduktuara vetëm në ndjekjen e programeve të televizorit, ajrim dhe lojërat e tavolinës (siç janë lojëra me letra dhe domino).

Sektori i çështjeve shoqërore kishte të programuar trajtime dhe këshillime individuale dhe në grupe me të paraburgosurit, në varësi të grup moshave dhe kërkesave të tyre. Por, këto aktivitete nuk ishin shumë efektive, pasi mungonin ambientet e punës për specialistët e këtij sektori. Sipas informacionit të stafit të institucionit, të paraburgosurit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato, ndaj dhe shkalla e informacionit ishte e limituar.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato formalisht ishin të plotësuara me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë. Në dosjet përkatëse ishin përfshirë si programet individuale të trajtimit ashtu dhe vlerësimet periodike.

Në lidhje me ajrimin u konstatua se ajrimi ditor zgjaste mbi 2 (dy) orë, sipas rregullores dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Disa nga të intervistuarit nga grupi i MKPT-së në dhoma, të pyetur për larminë e aktiviteteve apo programet që ata marrin pjesë, kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, me qëllim formimin dhe rritjen e kapaciteteve për rehabilitimin e tyre.

Është për tu theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁸.

Aktivitetet që zhvilloheshin, konsistonin në organizimin e festave me rastin e datave të rëndësishme festive ose fetare. Ambienti i kultit frekuentohej nga praktikuesit e fesë muslimane dhe besimtarët protestantë, me qëllim që ata të praktikonin ritet e tyre fetare, sidomos gjatë festave fetare.

Biblotekat e institucionit gjendeshin në çdo zyrë këshillimi dhe në momentin e inspektimit ato ishin të pajisur me libra. Librat ishin pjesë e inventarit të bibliotekës të cilët viheshin në dispozicion të të paraburgosurve apo të dënuarve për lexim sipas kërkesave. Aktualisht kishte 8(tetë) klasa që përdroreshin si klasa edukimi në të dy godinat, ku ndodheshin raftet me libra të ndryshëm. Bibloteka, kishte një numër të konsiderueshme librash, por pavarësisht kësaj, biblioteka nuk i përmbushte kërkesat e të paraburgosurve për lexim. Të paraburgosurit e regjistruar në bibliotekë, kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave, megjithëse numri i të regjistruarve ishte shumë i kufizuar.

Shërbimi Shëndetësor

Grupi i MKPT-së, gjatë vizitës inspektuese në IEVP “Jordan Misja” Tiranë, u fokusua dhe në mënyrën e funksionimit dhe ofrimit të shërbimit shëndetësor për të paraburgosurit në këtë institucion.

Personeli i shërbimit shëndetësor në institucion, sipas organikës përbëhej nga 3(tre) mjek, 2(dy) farmacist, 2(dy) stomatolog dhe 12 (dymbëdhjetë) infermierë. Mjeku i përgjithshëm ishte i punësuar me kohë të plotë, ndërsa 2 mjekët e tjerë (kardiolog dhe psikiatër), ishin të punësuar me kohë të pjesëshme, 4 orë në ditë dhe në çdo herë kur ishte e nevojshme (sipas kontratës të lidhur me institucionin). Stafii tjetër mjeksësor ishte i punësuar me kohë të plotë.

⁸ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARD_SETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf

Nga statistikat e personelit mjeksor të institucionit mbi sëmundshmërinë, në ditën e inspektimit, ishin 204 të paraburgosur të diagnostikuar me sëmundje të ndryshme, nga të cilët 85 të sëmurë kronikë, 35 të sëmurë me probleme të shëndetit mendor, 8 persona që marrin trajtim me metadon, 15 persona të sëmurë me diabet, etj.

Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve, funksiononte sipas kontratës tre paleshe mes institucionit, FSDKSH dhe depos farmaceutike, por për shkak të dinamikës të lëvizjeve të të paraburgosurve dhe vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale të tyre, kjo skemë nuk funksiononte rregullisht. Kjo situatë krijonte më tej problematika dhe vështirësi në pajisjen me librezë shëndetësore dhe për rrjedhojë edhe mungesa në sigurimin e ilaçeve, sipas nevojave që kishin të sëmurët kronikë.

Një problematikë tjetër, kishte të bënte dhe me emërtimin e ilaçeve në listën e ribursimeve, pasi i paraburgosuri para se të hynte në institucion ka përdorur ilaçe me emërtime të cilat nuk janë në listën e miratuar të ribursimit nga Ministria e Shëndetësisë, për të njëjtën sëmundje. Në këto kushte, të paraburgosurit që vuanin nga sëmundje kronike nuk pranonin ilaçet e siguruara nga lista e ribursimit, por pranonin të kuroheshin me ilaçet e siguruara nga familiarët e tyre.

Veç skemës trepalëshe që institucioni kishte lidhur me FSDKSH dhe depon farmaceutike, sigurimi me ilaçe në institucion, kryhej edhe nga dy burime të tjera, nëpërmjet furnizimit nga fondi i ilaçeve të siguruara nga DPB dhe blerjeve nga fondi i vetë institucionit, për të sëmurët me probleme të ndryshme shëndetësore.

Ambientet e shërbimit shëndetësor ndodheshin në katin e parë të godinës “A” dhe godinës “B” të institucionit. Ato kishin dhomën e mjekut për vizitat mjekësore, dhoma e stomatologut, si dhe farmacia për për shpërndarjen e ilaçeve në bazë të rekomandimit të mjekut të institucionit.

Dhoma e mjekut në secilën nga godinat dhe farmacia ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për kryerjen e vizitave mjekësore, të lyera dhe me kushte të mira higjieno-sanitare. Gjithashtu, dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige dhe sterilizues, njësia dentare funksiononte dhe mjeku stomatolog ishte i pranishëm në çdo kohë, sipas kërkesave të të paraburgosurve. Institucioni ishte i pajisur me ambulancë të re për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit, sipas rekomandimit të mjekut të institucionit.

Shërbimi i infermierisë funksiononte përgjatë 24 orëve, të cilët ndiqnin dinamikën e të sëmurëve kronikë dhe rastet e urgjencave. Shpërndarja e medikamenteve kryhej në bazë të rekomandimit të mjekut për çdo të sëmurë kronikë, duke qenë prezent në marrjen e terapisë nga i sëmuri dhe mos lënien e medikamenteve në dhomat e tyre.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyr regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin të protokolluar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*:

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa të menjëhershme, për hartimin dhe miratimin sa më parë të rregullores së brendshme të IEVP-së 313 “Jordan Misja”, Tiranë, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
2. Të merren masat e nevojshme, në bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë, për ndryshimin e urdhërit të përbashkët nr.104/5 prot., datë 19.06.2006 të Ministrit të Drejtësisë dhe nr.205/5 prot., datë 27.07.2006 të Ministrit të Shëndetësisë, *“Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”*, me qëllim përmirësimin e larmisë së menisë të ushqimit të të burgosurve.
3. Të merren masat e menjëhershme, për lidhjen e kontratave të punës midis institucionit dhe të paraburgosurve të punësuar, në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.10.2022 dhe të kryhen pagesat sipas parashikimit të VKM-së.
4. Të merren masa të menjëhershme, për rregullimin, mirëmbajtjen, eliminimin e lagështirës, sigurimin e ujit të rrjedhshëm, dizifektimit dhe pastërtinë higjeno-sanitare të ambientit ku ndodhen dhomat e tranzitit, të observimit dhe të veçimit, pasi në kushtet që ato ndodhen dëmtojnë rëndë shëndetin e personave që qëndrojnë në këto ambiente dhe sende të tjera të nevojshme për jetesë dinjitoze.
5. Të merren masat e nevojshme, për riparimin e rrjetit të brendshëm elektrik dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për ngrohje të dhomave të të paraburgosurve në godinën “A” të këtij institucioni, sipas kushteve klimaterike.
6. Të merren masa të menjëhershme, për ushtrimin e kontrollit, nxjerrjen e përgjegjësisë administrative të sektorit përgjegjës dhe sigurimin e furnizimit në bazë të normave mujore të paraburgosurit me detergjentë dhe pajisje hidrosanitare, për mbajtjen e higjenes dhe pastërtisë vetjake, mjediseve të banimit dhe ambienteve të përbashkëta.
7. Të merren masa të menjëhershme për afishimin në vende të aksesueshme për të paraburgosurit, të numrave për komunikimin me institucionin e Avokatit të Popullit, dhe të sigurohet ky komunikim në çdo kohë dhe pa pagesë.

8. Të merren masa të menjëhershme për shtimin e aktiviteteve psiko-sociale, trajtimit dhe këshillimit individual, si dhe aktiviteteve fetare me të paraburgosurit që ndodhen në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë (41 biss).
9. Të merren masat e nevojshme, për shtimin e aktiviteteve të përbashkëta me karakter kulturor, sportiv dhe edukativ me të paraburgosurit, me qëllim rritjen e aftësive të formimit dhe të kapaciteteve rehabilituese të tyre.
10. Të merren masa të menjëhershme për kompletimin e bibliotekave dhe dhomave të këshillimit në sektorë, me tituj të librave të rinj, me qëllim rritjen e interesit të të paraburgosurve për leximin e librave.
11. Të merren masat e nevojshme organizative, për plotësimin e vendeve vakante sipas strukturës organike të institucionit.
12. Të merren masa të menjëhershme, për vendosjen e një regjistri për evidentimin e korrespondencave të të paraburgosurve me institucionet e tjera jashtë IEVP, duke përshkruar kohën e nisjes dhe atë të marrjes në dijeni nga ankuesi, në lidhje me përgjigjen e institucionit të cilit ai është drejtuar.
13. Të merren masa për përcaktimin e kapaciteteve fizike të IEVP sipas normave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
14. Të përfundojë dhe të na komunikohet përmirësimi i kushteve për të burgosurit në sistemin 41 biss.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI